




REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr Prot
Dep. DPK	Br Prot 03-02/692/18
Dep.	Prot Nr
Nr. I faq	Data
Broj stranica 02	Datum 07-03-2018
Nr. pages	Date
	P. ISHTINE



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**



Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 06.03.2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

*I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-134/18 për z. Labinot Halilaj – Kryesues i Kuvendit Komunal të Drenasit, për shkak se nuk ka prova që dëshmojnë për situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.*

**II.** Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

**A r s y e t i m**

**I.** Rasti i hapur, me nr. protokoli AKK-03-02-134/18 për Zyrtarin e lartë, z. Labinot Halilaj Kryesues i Kuvendit Komunal të Drenasit, është hapur sipas kërkesës nga pala e tretë me pretendimin se ka qenë një situatë e dyshuar me konflikt interesi për shkak se është menduar se z. Halilaj ka ushtruar njëkohësisht edhe postin e Anëtarit përkatësisht Kryesuesit të Kuvendit Komunal të Drenasit edhe ka qenë Anëtar i Bordit në Ndërmarrjen Publike “Hekurudhat e Kosovës” sh.a.

Agjencia kundër Korrupsionit e ka hapur rast të dyshuar, por gjatë procesit të hetimit është konstatuar se z. Halilaj qysh në momentin e certifikimit të tij për Anëtar të Kuvendit Komunal të Drenasit ka dhënë dorëheqje nga pozita e Drejtorit të Bordit në Hekurudhat e Kosovës “Trainkos” sh.a. (e-mail njoftues për AKK-në nga pika kontaktuese me 22.09.2017).

Pikërisht për këtë arsye z. Halilaj në Agjencinë kundër Korrupsionit ka bërë edhe Deklarimin e pasurisë, pas largimit nga funksioni publik, me dt. 26.10.2017.

Z. Halilaj duke qenë Anëtar i Kuvendit Komunal, tani Kryesues, sipas të dhënave që ka Agjencia kundër Korrupsionit dhe deklaratimit personal të z. Halilaj ai, tash për tash nuk ushtron asnjë funksion tjetër publik që e klasifikon atë në mesin e zyrtarëve të lartë publik, dhe si rrjedhojë nuk kemi të bëjmë me konflikt interesi të kësaj natyre.


II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

  
/ Shaip Havolli /

